



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT  
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

Nr. 4523 prot.

Tiranë, më 28.10.2024

**Shpallje e kërkesës për aplikime për vlerësues të testeve të Maturës Shtetërore**

Qendra e Shërbimeve Arsimore shpall thirrjen për shprehje interesi për vlerësues të testeve të MSH 2025.

**Kriteret:**

**Kriteret që duhet të plotësojnë mësuesit që aspirojnë për t'u bërë vlerësues të testeve:**

Kandidati për vlerësues të testeve në provimet kombëtare është mësuesi që:

- ushtron profesionin e mësuesit sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi.
- ka të paktën 5 (pesë) vjet përvojë pune si mësues.
- ka dhënë lëndën përkatëse të paktën 1 (një) herë në të gjitha klasat e nivelit arsimor.
- ka të paktën kategorinë e kualifikimit "Mësues i kualifikuar" dhe është vlerësuar në provimin e kualifikimit të mësuesve me të paktën "Mirë".

**Dokumentet e nevojshme për aplikim:**

- ✓ CV e aplikantit sipas modelit Europass.
- ✓ 2 (dy) rekomandime nga drejtues të shkollave ose specialistë të ZVAP përkatëse.
- ✓ Fotokopje të noterizuar të librezës së punës.
- ✓ Kopje të dëshmisë së provimit të kualifikimit, ku të jetë vlerësuar me të paktën "Mirë".
- ✓ Vërtetim që ka 5 (pesë) vitet e fundit përvojë pune si mësues në AML.
- ✓ Fotokopje e dokumentit të identifikimit të vlefshëm.

**Procedura e aplikimit:**

Qendra e Shërbimeve Arsimore do të pranojë vetëm aplikime që janë përcjellë me rrugë postare në adresën e mëposhtme:

*Qendra e Shërbimeve Arsimore  
Blv. Zhan D'Ark, Nr. 23, Tiranë*

**Afati i dorëzimit të aplikimeve:**

Aplikimet mund të dërgohen në rrugë postare nga data 28.10.2024-01.11.2024.

**DREJTORI I PËRGJITHSHËM**

Aurora Balliu

